



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 52, datë 25.04.2012

PËR
MASËN E KONTRIBUTIT VJETOR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR
VITIN 2012

Në bazë dhe për zbatim të pikës 23, të nenit 14 dhe nenit 27 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 6, të Rregullores nr. 20, datë 19.03.2010, “Mbi masën e kontributit vjetor të shoqërive të sigurimit”, Planit Financiar të AMF-së për vitin 2012, miratuar me Vendimin nr. 145, datë 27.10.2011, si dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2011, të raportuara dhe të certifikuara, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”: “Autoriteti mbledh pagesa... nga shoqëritë e sigurimit, si kontribute në masën deri në 1.5% të primeve bruto...”.

Plani Financiar i AMF-së për vitin 2012, miratuar me Vendimin nr. 145, datë 27.10.2011, ka parashikuar se kontributet e shoqërive të sigurimit për vitin 2012 do të jenë në masën 1.5% të primeve bruto.

Në mbështetje të pasqyrave financiare të vitit 2011 të certifikuara, rezulton se diferenca midis të ardhurave vjetore në momentin e mbylljes së vitit financiar me shpenzimet është në shumën 27.072.576 lekë. Kjo shumë u pasqyrua në Pasqyrat Financiare, “*E ardhur e regjistruar për periudhat e ardhshme*” dhe njihet nga Autoriteti si parapagim nga kontributi që shoqëritë e sigurimit do të derdhin për vitin 2012, në bazë të nenit 6/3 të Rregullores nr. 20, datë 19.03.2010.

Përllogaritja e parapagimit të kontributeve për çdo shoqëri sigurimi është bërë në proporcion me shumën e kontributit vjetor të derdhur nga secila shoqëri sigurimi për llogari të Autoritetit, gjatë vitit ushtrimor 2011.

Për sa me sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shumën prej 27.072.576 lekë, si masë parapagimi të kontributit që shoqëritë e sigurimit do të derdhin për vitin 2012.
2. Të miratojë masën e parapagimit të kontributit për vitin 2012 për çdo shoqëri sigurimi në bazë vjetore dhe tre mujore sipas tabelës bashkëngjitur.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI